

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

KONTRATA

Komuna e Fushë Kosovës – Adresa: Rr. Tahir Zema nr.2 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në

njerën anë;

dhe

Shpk "Agani L.t.d" Adresa: Magj. Prishtin-Ferizaj me numër unik identifikues 811282706 (në

vazhdim "Furnizues"), përfaqësuar nga Samir Nebiu – drejtor ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një

kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Titulli: "Furnizim me pajisje mbrojtëse kundër virusit Covid-19 për

institucionet arsimore"

Numri i Prokurimit : 612 20 4209 136

Numri i brendshëm: 612 20 057 136

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Furnizim me 4000 cope Maska medicinale kirurgjike treshresore

, Dezinfektues per duar 300 liter-sipas specifikave në dosjen e tenderit.

1.2 Kontrata hynë në fuqi nga data e nënshkrimit dhe zgjatë 5 ditë pune.


1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 2 ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë: Depoja e Komunës

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP1 (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për gëshjet



që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3

Gjimi

3.1 Gjimi total i kontratës do të jetë: **1300.00 €**

Me fjalë: Njëmijë e treqindë Euro .

3.2 Gjimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të gjimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të gjimit sipas brezës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4

Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Kontrata përbëhet nga një dërgesë.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës.
4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5

Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në gjimin e kontratës.

Neni 6

Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *furnizimeve*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëm të likuiduar të barabartë me 0,25% në ditë të vlerës së *furnizimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përpimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërpjerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

11.1 Autoriteti Kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërprerë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit Kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti Kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërpjerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka parafirmuar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti Kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	<i>Dr. Don Gjoni</i>	Emri:	Bedri Obërtinca
Pozita:	<i>2 V. Dr. Gjoni</i>	Pozita:	Menaxher
Nënskrimi:	<i>[Signature]</i>	Nënskrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	<i>26.08.2020</i>	Data:	<i>26.08.2020</i>
Vula:	<i>[Stamp]</i>	Vula:	<i>[Stamp]</i>



Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Furnizim me pajisje mbrojtëse ndaj covid-19 për institucione shkollore në Fushë Kosovë

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi (€)	Shuma
1	Maska medicinale kirurgjike treshitresore	cope	4,000	0.10	400.00
2	Dezinfectues per duar	liter	300	3.00	900.00
TOTALI					1,300.00

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	AGANI LTD SHPK
EMRI DHE MBLEMRI I PËRFAQËSUESIT	DUGAGJIN AGANI
OE:	
NENSHKRIMI:	
DATA:	14.08.2020
VULA:	